



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 42
Prishtinë, 02 qershor 2009, në orën 11: 00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Morën pjesë: Sadik Idriz, Sllobodan Petroviq, Rita Hajzeraj, Teuta Hadri, Flora Brovina, Mimoza Ahmetaj, Gjylnaze Syla, Armend Zemaj, Bujar Bukoshi dhe Qamile Morina.

Mungoi: Nurishahe Hulaj.

Nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale(në vijim – MPMS) - ministri Nenad Rashiq, Behxhet Gaxhiqi – këshilltar i MPMS- së dhe Valbona Tolaj – kryesuese e Divizionit të Buxhetit.

Nga Ministria e Shëndetësisë (në vijim - MSH), Mybera Mustafa - zv.ministre.

Të pranishëm: Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit: Shpresa Haxhijaj - administratore dhe Fatime Qorri - zyrtare ligjore: nga NDI-ja: Shefki Kastrati: nga Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës: Nexhat Shatri: nga KDI-ja: Fitore Zeneli.

Mbledhjen e kryesoi: Sadik Idriz, - kryetar i Komisionit.

Komisioni i zhvilloi punimet me këtë

Rend dite

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;**
- 3. Shqyrtimi i Propozimplanit të veprimit të Kuvendit të Kosovës për sfidat e Raportit të progresit të Komisionit Evropian për vitin 2008;**
- 4. Shqyrtimi i Kornizës afatmesme të shpenzimeve për periudhën 2010 – 2012;**
- 5. Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Kryesuesi konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së kaluar pa ndryshime.

3. Shqyrtimi i Propozimplanit të veprimit të Kuvendit të Kosovës për sfidat e Raportit të progresit të Komisionit Evropian për vitin 2008

Sadik Idriz – Tha se në mbledhjen e kaluar Komisioni ka vendosur që për të diskutuar dy pikat qendrore të rendit të ditës të ftohen përfaqësuesit e ministrive përkatëse. Për të marrë informata, se ku ndodhet MPMS-ja, në përmbushjen e obligimeve që dalin nga Propozimplanit i veprimit të Kuvendit të Kosovës për sfidat e Raportit të progresit të Komisionit Evropian për vitin 2008, të ftuar e kemi ministrin Nenad Rashiq. Pas këtij takimi, Komisioni do ta përgatisë raportin përfundimtar lidhur me tri pikat e parapara në plan dhe do t'ia përcjellë Komisionit për Integritet Evropian. Hapi diskutimin.

Nenad Rashiq – ministër i MPMS - Tha se që kur e mori mandatin, në MPMS, gjeti një strukturë të paorganizuar, sidomos duke filluar nga pyetja e parë: dialogu social apo Këshilli Konsultativ Trepalësh ose tani Këshilli Ekonomiko - Social. Ky këshill nuk ka funksionuar që nga viti 2003. Kanë qenë dy grupe njerëzish, që nuk dëshironin të punonin me njëri - tjetrin. Për këtë MPMS ka marrë nismë të ngriste këtë çështje në nivel më të lartë - në nivel qeveritar, ku me një vendim administrativ të sqarohet kush është përfaqësues e kush jo. Tani kemi vendimin dhe ky këshill quhet “*Këshilli Ekonomiko Social*”, në përbërje të të cilit janë përfaqësues nga punëdhënësi dhe nga punëmarrësi, BSPK-ja, Këshilli Sindikal i Lirë i Kosovës, ndërsa nga ana e punëdhënësve kemi përfaqësues nga Oda Ekonomike e Kosovës dhe Aleanca për Biznes e Kosovës. Në këtë këshill janë edhe pesë përfaqësues nga ana e Qeverisë. Ka qenë një këshillë nga ana e ILO-së që numri i përfaqësuesve në këtë këshill të jetë sa më i madh. Na është dashur më shumë se një vit për ta bërë këshillin funksional.

Behxhet Gaxhiqi – këshilltar i MPMS – së – Lidhur me pikën: Dialogu Social - tha se marrëveshja për themelimin e Këshillit konsultativ trepalësh është nënshkruar më 26 tetor të vitit 2001, sipas së cilës këshilli ka 15 anëtarë, 5 përfaqësues nga punonjësit, 1 përfaqësues nga komuniteti joshqiptar, 5 përfaqësues nga punëdhënësi, një përfaqësues nga komuniteti joshqiptar dhe 5 përfaqësues nga Qeveria (konkretisht një nga MPMS, një nga MTI, një nga MEF dhe një nga MSHP). Me qëllim të inicimit të procedurave për dialogun social është nxjerrë Udhëzimi administrativ 2001/17. Këshilli konsultativ trepalësh nuk është funksional. Kontrata Kolektive është nënshkruar më 20. 09. 2004, por nuk është zbatuar për shkak të implikimeve buxhetore. Në pamundësi të zbatimit të kësaj kontrate më 01. 07. 2005 nga partnerët socialë, pra: Qeveria e Kosovës, Oda Ekonomike e Kosovës dhe BSPK-ja, është nënshkruar Anekskontrata, me të cilën disa nga dispozitat e kontratës së përgjithshme realizohen. Për implementimin e kontratës së përgjithshme MPMS-ja ka kërkuar nga MEF-i 45 milionë euro. MEF-i ka siguruar vetëm 1 milion e 200 mijë euro, konkretisht për nenin 23(pushimi i lehonisë). Ky nen zbatohet vetëm për shërbyesit civilë. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, pas shumë analizave të bëra, në mungesë të mjeteve për pagesën e pushimit të lehonisë për sektorët e tjerë, kërkoi nga Qeveria ta marrë një vendim, në mënyrë që kjo pagesë të fillojë së zbatuari vetëm për të punësuarat në Shërbimin civil të Kosovës.

Qeveria e Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31.05.2006, mori vendimin nr. 02/201, të datës 31. 05. 2006, për fillimin e zbatimit të pushimit të lehonisë për të punësuarat në

Shërbimin Civil të Kosovës, që do të marrin 70% të pagës minimale në Kosovë, e përcaktuar nga Këshilli Konsultativ Trepalësh.

Kosova ende nuk ka ligj për sindikatat dhe për grevat. Projektligji për të Drejtat dhe Liritë e Organizimit Sindikal në Kosovë, si dhe Projektligji i Grevave, kanë ngecur në procedurë për shkak të mos miratimit të Ligjit të Punës. Mirëpo, në kuadër të strategjisë legislative të vitit 2009, janë të parapara të dy këto projektligje. Ministri e ka angazhuar Departamentin Ligjor dhe ka formuar grupe pune lidhur me këto projektligje.

Sa i përket pikës P - 107 - Ministria e Punës dhe Mirëqenës Sociale, nëpërmjet institucioneve profesionale, që aktualisht është mandatar me ligj, harton dhe implementon politika dhe ofron shërbime sociale për mbrojtjen dhe ri-integrimin e viktimave të trafikimit. Në kuadër të kësaj, qendrat për punë sociale, që veprojnë në të gjitha komunat, kanë mandat ligjor të ofrojnë mbrojtje dhe shërbime sociale për viktimat e trafikimit me theks të veçantë për të miturit - viktima të trafikimit dhe marrin pjesë aktive me të gjithë partneret e tjerë në risocializimin të tyre. MPMS-ja ka marrëveshje bashkëpunimi me OJQ që kanë programe për viktima të trafikimit. Këto shërbime janë të specializuara.

Sa i përket pikës P - 72 - *Pse Kosova nuk ka ende plan të veprimit për persona me aftësi të kufizuara*. Kosova, pra Qeveria e Republikës së Kosovës, ka Plan kombëtar të veprimit për personat me aftësi të kufizuara në Republikën e Kosovës. Plani është miratuar nga Qeveria dhe pritet implementimi i tij. Monitorues për përcjelljen e zbatimit është Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër të Qeverisë së Kosovës. Ministri brenda vitit 2008 ka arritur t'i hapte 5 qendra shtëpi bazë të komunitetit në institutin e Shtimes. Njoftimet më të hollësishme i keni në raportin me shkrim.

Sadik Idriz – Sa i përket pikës që ka të bëjë me personat me aftësi të kufizuara tha se kemi marrë informatën se ka Plan kombëtar, por për këtë pikë ka për të dhënë mendimin edhe Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Peticione dhe Persona të Pagjetur. Sa i përket Komisionit për Ofrimin e Përkrahjes Materiale për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara, edhe kjo do të përfshihet në raportin e Komisionit, ndërsa sa i përket pikës që ka të bëjë me integrimin e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore, Komisioni për Shëndetësi, së bashku me Komisionin për të Drejtat e Njeriut dhe Komisionin për Punë të Brendshme dhe Siguri, do të organizojë një dëgjim publik.

Gjylnaze Syla – Tha se esenca e përmirësimit të pikës “*dialogu social*” do të ishte nga aspekti ligjor. Domethënë së pari, në vitin 2009, duhet të kalojnë Ligji për punën, pastaj Ligji për sindikata dhe grevë. Këto ligje kur do të procedohen në Kuvendin e Kosovës? Ku është dallimi ndërmjet Këshillit Ekonomik Social dhe Këshillit Trepalësh?

A ka plan MPMS-ja, që kontrata kolektive, varësisht nga buxheti, të zbatohet në mënyrë parciale? Sa ka bashkëpunim ndërmjet MEF-it dhe MPMS-së, që kjo kontratë të zbatohet në mënyrë parciale, meqë zbatimin e tërësishëm të saj buxheti i Kosovës nuk mund ta mbulojë.

Çështja e personave me aftësi të kufizuara, më tepër ka të bëjë me kapacitetet rehabilituese të Kosovës. A ka diçka ministria lidhur me këtë pikë? A ka bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, sa i përket çështjes së personave me aftësi të kufizuara në shkollat e Kosovës?

Pika që ka të bëjë me trafikimin e qenieve njerëzore - Komisioni për Shëndetësi ka të bëjë me tepër me risocializimin e këtyre viktimave. MPMS-ja më tepër po merret me riatdhesimin e viktimave. Sa është zbatuar plani i veprimit dhe nëse ka filluar të zbatohet në janar, atëherë deri kur pritet të zbatohet në tërësi?

Rita Hajzeraj – Theksoi se jemi të vetëdijshëm që pa u proceduar Ligji për punën nuk mund të procedohen Ligji për grevat dhe Ligji për sindikatat, por ne kemi kaluar Ligjin për punësimin e të huajve edhe pa kaluar Ligji i punës. Sipas strategjisë legislative për vitin 2009 është paraparë të procedohet Projektligji për punën, por sa po shohim nga ky takim, as këtë vit nuk do të procedohet ky Projektligj.

Pyeti: 5.5 milionë euro që MPMS-ja i ka paraparë për Ligjin e punës, çka konkretisht është përfshirë këtu?

Marrëveshja trepalëshe që ishte më parë e nuk funksiononte për shkak të financave, tani keni bërë Këshill Ekonomiko - Social, a do të ketë problem edhe kjo marrëveshje ekonomiko – sociale, për shkak të financave dhe ku keni paraparë t'i siguronit financat, për të funksionuar më mirë ky këshill?

Sa i përket pikës që ka të bëjë me rehabilitimin e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore - përveç mekanizmave shtetërorë - a janë duke ndihmuar edhe organizma të tjerë joshetërorë? A ka hapësirë të njaftueshme për risocializimin e këtyre personave?

A ka ndërmarrë diçka MPMS-ja që edhe personat në vendet më të thella të mund të aplikojnë për përkrahje, sepse ata persona, ndoshta nuk kanë njohuri që ka ligj për përkrahje të tyre. A keni ndërmarrë ndonjë aktivitet si ministri të hulumtoni për këta persona.

Teuta Hadri – Tha se kemi pritur që njoftimet nga MPMS-ja do të jenë më të hollësishme dhe më të sakta. Nuk mund të kemi përparim nëse nuk e kemi Ligjin e punës, pavarësisht nga përpjekjet e Komisionit për përkrahjen e kësaj ministrie. Pyeti: edhe sa kohë nevojitet të procedohet Ligji i punës, sepse të gjitha ligjet e tjera janë dhe mbeten peng i Ligjit të punës. Pushimi i lehonave, sipas vendimit të Komisionit në mandatin e kaluar 50% të kompensimit e jep punëdhënësi dhe 50 % punëmarrësi, kurse sot dëgjova për një kompensim 3+3+ 3. Kush e ka bërë këtë ndryshim?

Nenad Rashiq, ministër i MPMS - së – Tha se Ligji për punën, ka implikime shumë të mëdha buxhetore dhe kjo është e njohur për të gjithë. Ky projektligj, të hënën ka qenë në dorë të Grupit të punës të Qeverisë. Ne kemi kërkuar model si të miratojmë dhe zbatojmë këtë ligj në mënyrë parciale. Disa gjëra FMN-ja nuk do të na lejojë t'i bëjmë, sepse konsiderojnë që do të ketë efekte negative për shoqërinë.

Armend Zemaj – Tha se nuk i pëlqen politika sociale në Kosovë edhe pse ai si deputet i takon koalicionit të Qeverisë, por ai tha se kjo është diçka e trashëguar. Problemi është më i madh dhe nuk mendoj se duhet të ndalemi vetëm te Ligji i punës. Ne duhet të krijojmë politika që edhe shfrytëzuesit e skemave sociale në një formë t'i orientojmë drejt punësimit. Në Ligjin për rehabilitimin dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara është paraparë detyrimi për organizatat punëmarrëse ta kenë të punësuar një numër të caktuar të personave me aftësi të kufizuara. Pyetje: a ka MPMS-ja informata se sa po zbatohet kjo dispozitë?

Flora Brovina – Theksoi se çështje të njëjta po diskutohen tri mandate. Nuk mund të paramendojmë MPMS– në, ose Qeverinë pa Ligjin e punës. Jemi të vetëdijshëm që ligji ka kosto të lartë buxhetore dhe me 5 ose 6 milionë nuk mund as të imagjinojmë se do të zgjidhet problemi. Dhe nëse çështja e kostos përfshin shumë më të madhe për pushimin lehonisë, jua kujtoj se këtu nuk përfshihet vetëm MPMS-ja, por edhe MSH-ja, MASHT-ja, MTPTK-ja. Kjo çështje është e Qeverisë dhe ata duhet të diskutojnë për këto çështje me FMN. FMN-ja është kritike, por jo gjithmonë ka të drejtë. Ne kemi mortalitetin e foshnjave më të lartin në Evropë dhe si do ta zvogëlojmë këtë nëse nuk kujdesemi për

nënën dhe fëmijën. Çështja e punësimit duhet të trajtohet si çështje multidisiplinore, e jo vetëm si detyrim i MPMS-së.

Behxhet Gaxhiqi – këshilltar i MPMS - së – Kjo qeveri nuk mund t'i mbulojë të gjitha vrimat që janë hapur vite me radhë. MPMS-ja nuk është ajo që e bllokoi Ligjin për punën.

Sadik Idriz – Tha se Komisioni do ta hartojë raportin për Komisionin për Integritet Evropian. Pyetja sa i përket Ligjit të punës ishte pyetje me vend, sepse është ligj bazë. Ligji për sigurime shëndetësore, që në mandatin e kaluar ka kaluar në Kuvend, por nuk është nënshkruar nga PSSP-ja. Ligji për punën është paraparë që të procedohet këtë vit, ndërsa mundësitë për procedimin e tij janë shumë të vogla.

4. Shqyrtimi i Kornizës afatmesme të shpenzimeve për periudhën 2010 – 2012

Sadik Idriz – Shtoi se për të diskutuar lidhur me këtë pikë të rendit të ditës të ftuar i kemi përfaqësuesit e MPMS-së dhe MSH-së. Hapi diskutimin.

Mybera Mustafa –zv.ministre në Ministrinë e Shëndetësisë- Tha se ministri i shëndetësisë me vendimin numër 150, të muajit të tretë 2009, ka emëruar këshillin për hartimin e kornizës afatmesme të shpenzimeve për periudhën 2010-2012. Në përbërje të këtij këshilli kanë marrë pjesë përfaqësues nga MSH-ja, QKUK-ja, spitalet rajonale, shëndetësia primare, FSSHK-ja dhe MEF-i. Korniza buxhetore e sivjetme faktikisht është vazhdimi i asaj të kaluarës, duke e pasur parasysh se përqindja e GDP-së për këtë vit është në rënie. Si kryesuese e Grupit të punës i kam formuar katër nëngrupe të punës: Grupin për misionin, Grupin për projektin në bazë të kodeve buxhetore, Grupin bosht për përmbledhjet dhe Grupin për donacione. Në bazë të kësaj pune kemi arritur në një rezumë. Për vitin 2009 kemi pasur 67 milionë euro, për vitin 2010 na është caktuar shuma 70 milionë euro. Ne kemi pasur rritje rreth 35 % të buxhetit. Kjo është minimumi, nëse prioritet është shëndetësia. Për vitin 2010 kemi kërkuar 20 milionë për shpenzime operative. Janë përafërsisht 2 milionë shpenzime kapitale, kryesisht nuk jemi orientuar për shpenzime kapitale, sepse mendojmë se për ta stabilizuar gjendjen nuk na nevojiten shumë ndërtesa të reja, sa na nevojiten për shpenzimet bazë operative dhe për kuadrin bazë operacional.

Valbona Tolaj – MPMS - Tha se MPMS-ja, me qëllim të përmirësimit të punësimit dhe të mirëqenies sociale, ka tri synime: avancimi në zbatimin e politikave të ngritjes së shkallës së punësimit në nivel vendi, ngritja e mirëqenies dhe mbështetja e familjeve me ndihma dhe shërbime sociale për kategoritë e rrezikuara të shoqërisë. Monitorimi dhe reformimi potencial i programeve aktuale pensionale, kërkon mundësi të qëndrueshme fiskale. Hollësitë e kësaj kornize i keni me shkrim.

Armend Zemaj – Pyeti sa ka kërkuar në total MPMS-ja?

Mimoza Ahmetaj – Tha se vitin e kaluar e kemi pasur një debat për punën e gjashtë mjekëve psikiatër nga qendrat për shëndet mendor që paguheshin sipas një projekti norvegjez. Kjo qendër ishte rrezik të mbyllej, sepse projekti ka përfunduar, ndërsa MSH nuk ka pasur mundësi t'i paguajë këta punëtorë, sepse nuk kishte të drejtë ta rriste numrin e punëtorëve. Pyeti zv. ministren e Shëndetësisë; a janë përfshirë këta punëtorë në këtë Kornizë afatmesme të shpenzimeve?

I pyeti përfaqësuesit e MPMS-së, për Ligjin për skemën sociale. Për të shuma ishte rreth 30 milionë dhe nënkuptonte se hynin edhe ndryshimet që janë paraparë të bëhen me këtë ligj apo ato ndryshime kanë kosto shtesë që nuk janë përfshirë në këtë kornizë?

Qamile Morina – Tha se sipas kësaj kornize nuk ka riorganizim struktural të MSH-së. Domethënë gjendja po vazhdohet në mënyrë të njëjtë. Edhe pse buxheti është rritur, diku 21% janë paraparë për investime kapitale si; renovimi i institucioneve shëndetësore 7 milionë e 900 mijë euro (nuk ka precizim të hollësishëm për pajisje mjekësore institucionale), janë 9 milionë euro, infrastruktura e institucioneve shëndetësore pa definim - 4 milionë e 100 mijë euro, rrjeti i avullit të ujit të ngrohët - ne e dimë që për këtë ka investuar “DIFID”. Në pikën përmirësimi i menaxhimit të resurseve ekzistuese dhe të cilësisë së shërbimeve, MSH-ja ka paraparë ngritjen e llogaridhënies pas definimit të roleve dhe të përgjegjësive të institucioneve shëndetësore, departamenteve të njëjve dhe të punësuarve brenda tyre. Sipas ligjit Ministria e Shëndetësisë është mbikëqyrëse e të gjitha proceseve që ndodhin në këto institucione shëndetësore dhe nëse ndodhin keqpërdorime dhe keqmenaxhime, MSH mbetet përgjegjëse. E habitshme është renovimi i ndërtesës së Gjinekologjisë. Gjinekologjia është ndërtuar pas luftës dhe është institucioni më i ri. Këto projekte po dështojnë dhe me to po tregohet dështimi i madh në shëndetësi. Me vite të tëra punohet në këto projekte dhe nuk ka monitorim se ku kanë arritur dhe ku kanë dështuar në realizimin e tyre. Në këtë kornizë parashihej renovimi i ndërtesës së pediatriisë. Ne e dimë se ndërtesa e pediatriisë është rinovuar. Edhe nëse MSH-ja nuk do të ketë përkrahje tjetër financiare, mjetet që i keni të ndara si mendoni t'i shfrytëzoni? Me shumë dëshirë do të përkrahja një kornizë afatmesme të shpenzimeve të MSH-së, por me këtë se çfarë na është dorëzuar, nuk e konsideroj se kjo kornizë duhet të kalojë, sepse me të janë paraparë, sikur në vitet e kaluara vetëm furnizime dhe renovime. Për shërbimet sociale, kategoria I dhe II e MPMS – së parasheh 28 milionë e 300 mijë euro, kurse MPMS-ja ka paraparë vazhdimin e implementimit të rregullores për pensionet bazike 58 milionë. Në Ligjet për sigurimet sociale janë përfshirë këto kategori. Për vazhdimin e zbatimit të Ligjit për personat me aftësi të kufizuara keni paraparë 10 milionë. Edhe kjo kategori përmendet në skemën sociale.

Teuta Hadri – Pati vërejtje për MSH- në dhe për Qeverinë, sepse kanë dështuar në shëndetësi. Të gjithë janë deklaruar se shëndetësia duhet të jetë prioritet. Sipas kësaj kornize shëndetësia nuk është prioritet. MSH-ja duhet t'i bëjë presion Qeverisë. Sa u përket shpenzimeve, diku 8 milionë harxhime ka kjo ministri dhe nga ato makroprojekte askund nuk shkruan se çka mbetet nga ato. Prej vitit në vit duhet të ketë ndryshime të mëdha dhe këto ndryshime nuk figurojnë askund në këtë kornizë. Ministri i Shëndetësisë ka dalë në media dhe ka konfirmuar se ka përfunduar makroprojekti i kardiokirurgjisë, ndërsa ky projekt prapë është futur në këtë kornizë. Investimet që janë bërë në gjinekologji janë bërë nga donacione. Edhe në mandatin e kaluar në kornizat e tuaja kanë figuruar si investime të MSH - së, madje kjo ministri nuk ka ndarë mjete për këtë projekt. Ju ftoi që së bashku me ministrin ta vizitoni gjinekologjinë, ku gjysma e shtretërve janë të dëmtuar, nuk ka dollapë për pacientë.

Gjynaze Syla – Pyeti: nëse MPMS-ja ka një listë të rreziqeve fiskale. Ajo si rrezik e sheh indeksin pensional, ose kostoja e Ligjit të punës, implementimi i Ligjit sigurimi pensional, invalidor etj. Çka ka ndërmarrë MPMS-ja lidhur me buxhetin duke pasur parasysh këto rreziqe fiskale?

Pyeti zv. ministren e Shëndetësisë: MSH-ja ka kërkesa shtesë për financim - vitin 2010 mbi 20 milionë, për vitin 2011 mbi 30 milionë, për vitin 2012 mbi 33 milionë. Sipas

kësaj kornize, duke përfshirë këtu kujdestaritë me rritje, pastaj pagesën 44 euro, që del sipas kësaj se në vitin 2009 nuk do ta kemi Ligjin për sigurime shëndetësore.

Rita Hajzeraj – Lidhur me pikën - Monitorimi dhe reformimi potencial i programeve adekuate pensionale, duke kërkuar mundësi të qëndrueshme fiskale departamenti i pensioneve dhe i invalidëve të luftës është paraparë buxheti vetëm për vitin 2009, ndërsa për vitet e tjera nuk është paraparë. Pyeti: a planifikon MPMS-ja ta shuajë këtë departament, apo si qëndron puna?

Flora Brovina – Në mesin e objektivave strategjike MSH-ja ka paraparë përmirësimin e sistemit të referimit. Në një ministri ku nuk funksionon sistemi i referimit, atëherë nuk mund të kemi as strategji.

Armend Zemaj – Në radhë të parë duhet ta kemi të qartë çfarë është KASH- i. Por edhe ministritë përkatëse duhet të kenë parasysh që pas hartimit të KASH-it, në vitet pasuese do të ketë shumë pak mundësi lëvizjeje. Nga KASH shihet se MSH-ja nuk ka përkrahje buxhetore, duke marrë parasysh kriteret e përcaktuara për tri vitet e ardhshme. Nëse ne sot mbështetemi në atë se ka mangësi në MSH, nuk ka plotësim në listën esenciale të barërave dhe për tre vjetët e ardhshëm parashihet rritje buxhetore vetëm për 6 milionë, atëherë ne si deputet e kemi për detyrë t'i ndihmojmë këtij sektori. Por edhe MSH ka mangësi - cila është kërkesa e MSH-së në MEF për Fondin e Sigurimeve Shëndetësore, nëse nuk parashihet me këtë kornizë, ajo nuk mund të jetë as projekt i veçantë. Këto janë probleme të parametrave të planifikuar.

Mybera Mustafa – Tha se Ligji për sigurime shëndetësore nuk është përfshirë në kornizën afatmesme të shpenzimeve, sepse është një projekt i veçantë. Të 16 punëtorët e shëndetit mendor të Projektit norvegjez, janë përfshirë në këtë kornizë afatmesme të shpenzimeve. MSH-ja kur e ka rritur numrin e punëtorëve i ka konsultuar organizatat buxhetore dhe ato materiale. Ne i kemi dorëzuar në MEF, në mënyrë të detajuar, por normalisht që kjo është kornizë e përmbledhur nga MEF-i.

Kujtoj anëtarët e Komisionit se po diskutohet për kornizën afatmesme të shpenzimeve, projektet e detajuara do të bëhen tani me qarkoren tjetër, ku tashmë është formuar grupi i punës. Detajet që i kërkon ju, ne i dorëzojmë në MEF, pastaj ata e bëjnë përmbledhjen. Projektet e donatorëve nëse nuk mund t'i fusim në këto tabela, sepse edhe ne, si ministri na kontrollojnë dikush.

Valbona Tolaj – MPMS – ja - Tha se shuma 30 milionë përfshin edhe ndryshimet e propozuara për Ligjin për skemën sociale. MPMS-ja pa Projektligje ka kërkuar në total 198 milionë e 374 mijë euro. Me rishikim të buxhetit MPMS-ja ka bërë kërkesë për rishikim të programeve. Jemi në minus, te pensionet bazë diku 5 milionë e 300 mijë euro, kemi bërë kërkesë në MEF. Po ashtu kemi kërkuar mjete shtesë për programin e pensioneve me aftësi të kufizuara diku mbi 900 mijë euro. Por ne kemi shikuar edhe mundësitë e brendshme për lëvizje të mundshme. Departamenti i pensioneve dhe i invalidëve të luftës nuk do të shuhet. Totali i buxhetit për këtë kategori është 23 milionë.

5. Të ndryshme

Sadik Idriz - I njoftoi anëtarët e Komisionit për shkresën e punëtorëve të Banjës së Klllokotit lidhur me propozimkërkesën për zgjidhjen e statusit juridik të Banjës së Klllokotit. Vendimi për privatizim ose jo të Banjës së Klllokotit është çështje e Qeverisë, e

jo Komisioni. Por në mënyrë më të hollësishme Komisioni në një nga mbledhjet e radhës do ta shqyrtojë këtë shkresë.

Gjynaze Syla – Propozoi që për mbledhjen e radhës Komisioni të vendosë për monitorimin e zbatimit të ndonjë ligji (Ligji për skemën sociale, siç është pajtuar Komisioni në mbledhjen e kaluar), si dhe të diskutojë për zbatimin e planit të punës së Komisionit.

Mimoza Ahmetaj – Tha se ndoshta do të ishte mirë që monitorimi i Ligjit për skemën sociale të bëhet pasi të ketë kaluar plotësimndryshimi në Kuvend, meqë është në procedim e sipër.

Sadik Idriz – Tha se ne nuk mund ta monitorojmë një ligj pa kaluar një vit nga dita e shpalljes së tij. Por në mbledhjen e radhës do të vendosim se cilin ligj do ta monitorojmë dhe do të formojmë grupin e punës i cili do të merret me monitorimin.

Mbledhja përfundoi në orën 12:40

E hartoi
Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Sadik idriz